UNIVERSITETI I MITROVICËS "ISA BOLETINI"
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE
DEPARTAMENTI: INFORMATIKË INXHINIERIKE

PUNIM DIPLOME

Mentori
MSc. Halil Sadiku, PhD Cand.

Kandidati
Arbnor Jusufi

Mitrovicë 2021

UNIVERSITETI I MITROVICËS "ISA BOLETINI"
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE
DEPARTAMENTI: INFORMATIKË INXHINIERIKE

PUNIM DIPLOME

VLERËSIMI I MODELEVE TË ZHVILLIMIT TË APLIKACIONEVE NË GJUHËN PROGRAMUESE C#

Mentori
MSc. Halil Sadiku, PhD Cand.

Kandidati
Arbnor Jusufi

Mitrovicë 2021

DEKLARATË E ORIGJINALITETIT

Me anë të kësaj deklarate dëshmojë që ky punim është punë origjinale dhe nuk është botuar më herët në ndonjë universitet apo institucion tjetër akademik. Po ashtu, deklaroj që punimi nuk përmban material të botuar apo shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç siç deklarohet në përmbajtjen e këtij teksti.

Po ashtu deklarojë që kamë respektuar në përpikëri rregullat themelore akademike të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” për punimin e kësaj teme të diplomës.

_____

Nënshkrimi

ABSTRAKT

Modelet e zhvillimit janë një koncept i përgjithshëm për zgjidhjen e një problemi, të cilat shpesh ngatërrohen me algoritmet sepse që të dyja janë udhëzime për zgjidhjen e problemeve të shpeshta gjatë programimit por që kanë një dallim të qartë mes vete, algoritmet përcaktojnë një listë veprimesh që mund te arrijnë deri të zgjidhja e problemit kurse modelet janë një përshkrim i nivelit më të lartë të një zgjidhjeje, ku mund të shihen rezultatet por metoda e zbatimit varet nga personi që përzgjidh modelin. Të gjitha modelet mund të karakterizohen nga qëllimi i tyre, ato ndahen në tri grupe kryesore:

- Modelet Krijuese (Creational Patterns)
- Modelet Strukturore (Structural Patterns)
- Modelet e Sjelljes (Behavioral Patterns)

Për të i sqaruar më mirë modelet e zhvillimit është krijuar edhe një aplikacion i cili ka për qëllim menaxhimin e punëtoreve të një kompanie dhe përdorë dy modelet më të përdorura. Aplikacioni është i shkruar në gjuhën C#, gjuhë programuese e orientuar në objekte, për ta mundësuar aplikacionin të punojë në Windows është përdorur edhe .Net Framework, Në përgjithësi ky punim ka për synim kuptimin dhe zbatimin e modeleve.

Fjalët kyçe: C#, .Net Framework, Visual Studio, SSMS, Modelet, SOLID, UML.

FALENDERIM

Së pari falënderoj Zotin e madhërishëm për diturin dhe shëndetin që më jepi gjatë këtij udhëtimi tre vjeçare. Një falënderim nga zemra shkon për familjen time që më mbështeten, përkrahen dhe më motivuan vazhdimisht për çdo hap të udhëtimit tim akademik, gjithashtu falënderoj kolegët dhe shokët për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre. Gjithashtu falënderoj edhe mentorin tim të temës së diplomës MSc. Halil Sadiku (PhD Cand) për përkrahjen, motivimin, pozitivitetin dhe mbështetjen e vazhdueshme gjatë punës së temës së diplomës.

PËRMBAJTJA

1. HYRJE 5
2. TEKNOLOGJITË E PËRDORURA 6
2.1 C# 6
2.2 .NET Framework 7
2.3 Visual Studio 8
2.4 SQL Server Management Studio (SSMS) 9
2.4.1 Object Explorer 10
3. MODELET E ZHVILLIMIT NË GJUHËN PROGRAMUESE C# 11
3.1. Klasifikimi i modeleve 11
3.2. Historiku i modeleve të zhvillimit 12
3.3 SOLID Parimet 12
3.4 UML 13
3.5 Creational Patterns 15
3.5.1 Factory Method 16
3.6 Structural Patterns 19
3.6.1 Adapter Pattern 20
3.7 Behavioral Patterns 24
3.7.1 Observer Pattern 24
4. RAST STUDIMI – ZHVILLIMI I APLIKACIONIT 31
4.1 Implementimi i Factory Method 33
4.2 Implementimi i Observer Pattern 38
5. PËRFUNDIMI 42
6. LITERATURA 43
TABELA E FIGURAVE 45

1. HYRJE

Katër autorët Erich Gamma, Richard Helm, Ralph Johnson dhe John Vlissides botuan një libër të quajtur *DESIGN PATTERNS – Elements of Reusable Object-Oriented Software* [1] në vitin 1994, duke iniciuar konceptet themelore të modeleve të zhvillimit në dizajnimin e softuerit, libri i tyre korri aq sukses të madh saqë atyre u dha titulli Gang of Four (GOF).

Modelet e zhvillimit janë zgjidhje tipike për problemet e njëjta që ndodhin vazhdimisht gjatë dizajnit të një softueri. Një model i zhvillimit nuk është një zgjidhje që mund të përdoret menjëherë nëse haset në ndonjë problem por është një përshkrim i detajuar se si mund te zgjidhet një problem, pastaj mund të implementohet në kodin e programit. modelet e zhvillimit ndryshojnë nga shkalla e zbatimit dhe kompleksiteti i tyre. Modelet e kompleksitetit më të ulët i quajmë *idioma* këto modele aplikohen vetëm në një gjuhë programuese, ndërsa modelet me kompleksitet të lartë quajmë modele *arkitektonike* të cilat mund të përdoren në të gjitha gjuhët programuese. Përdorimi i modeleve të zhvillimit në softuerin tonë jo vetëm që i eliminon problemet e vazhdueshme por edhe e bënë më të mirëmbajtur [2].

Pra ky punim diplome trajton modelet e zhvillimit si krijimin, klasifikimin dhe zbatimin e tyre në programim. Me anë të një projekti kemi ilustruar përdorimin e modeleve të zhvillimit në projekte reale.

2. TEKNOLOGJITË E PËRDORURA

Modelet e zhvillimit kanë një zbatim të gjerë në të gjitha gjuhët programuese. Për punimin e projektit me anë të cilit do të ilustrojmë përdorimin e modeleve të zhvillimit të cilin do të shtjellohet më vonë gjatë këtij punimi, janë përdorur teknologjitë të cilat janë duke u mësuar aktualisht në Universitetin e Mitrovicës, ndër të cilat janë:

- C#
- .NET Framework
- Visual Studio
- SQL Server Management Studio

2.1 C#

C# është një gjuhë programimi moderne, e orientuar në Objekte dhe e tipit të sigurt. C# i ka rrënjët në familjen C të gjuhëve dhe do të jetë menjëherë e njohur për programuesit C, C ++, Java dhe JavaScript [3]. C# u zhvillua brenda Microsoft. Shpikësit kryesorë të kësaj gjuhe ishin Anders Hejlsberg, Scott Wiltamuth dhe Peter Golde. Zbatimi i parë i shpërndarë gjerësisht i C# u lëshua nga Microsoft në korrik të vitit 2000, si pjesë e .NET Framework [4]. Figura 1 tregon se si printohet fjala “Hello World” në gjuhën programuese C#.

```
1   using System;
2
    0 references
3   internal class Hello
4   {
        0 references
5       private static void Main(string[] args)
6       {
7           Console.WriteLine("Hello World");
8           Console.ReadKey();
9       }
10  }
```

Figura 1 "Hello, World” në C#

Versioni aktual i C# është 9.0, i cili shton shumë veçori dhe përmirësime, ndër to janë [5]:

- Records - janë një lloj reference që ofron metoda të sintetizuara për të siguruar semantikë vlere për barazinë. Regjistrimet janë të pandryshueshme nga parazgjedhja.

- Init only setters - sigurojnë sintaksë të qëndrueshme për të iniciuar anëtarët e një objekti.
- Top-level statements - largon ceremoninë e panevojshme nga shumë aplikacione.

2.2 .NET Framework

.NET është një platformë falas, ndër-platformë (cross-platform), zhvilluese me burim të hapur për ndërtimin e shumë llojeve të ndryshme të aplikacioneve. me .NET, mund të përdorni shumë gjuhë, redaktorë dhe biblioteka për të ndërtuar për ueb, celular, desktop, lojëra dhe IoT.
Versioni i fundit i .NET është .NET 5 Microsoft e kalojë një gjeneratë që të mos ngatërrohet më versionin e .NET Framework. Zhvilluesit që shkruajnë aplikacione .NET 5 do të kenë qasje në versionin dhe veçoritë më të fundit të C#. .NET 5 bashkë me C# 9 sjellin shumë tipare të reja në gjuhë tiparet të cilat janë diskutuar në faqe 5 kurë është folur rreth C# [6].

.NET Framework është një platformë zhvillimi që përfshin një Common Language Runtime (CLR), e cila menaxhon ekzekutimin e kodit dhe një Base Class Library (BCL), e cila siguron një bibliotekë të pasur të klasave për të ndërtuar aplikacione. Microsoft u përpoq që i gjithë implementimi të funksionojë më së miri në Windows. Që kur .NET Framework 4.5.2, ai ka qenë një komponent zyrtar i sistemit operativ Windows. .NET Framework është instaluar në mbi një miliard kompjuterë kështu që duhet të ndryshojë sa më pak të jetë e mundur për arsye se rregullimet e defekteve në kod mund të shkaktojnë probleme, prandaj përditësohet rrallë [7].

Të gjitha aplikacionet në një kompjuter të shkruar për .NET Framework ndajnë të njëjtin version të CLR dhe bibliotekave të ruajtura në Global Assembly Cache (GAC), gjë që mund të çojë në probleme nëse disa prej tyre kanë nevojë për një version specifik për pajtueshmëri [7].

2.3 Visual Studio

Visual Studio është një vegël krijues që mund të përdoret për të modifikuar, korrigjuar gabimet dhe për të ndërtuar kodin dhe më pas për të publikuar një aplikacion. Visual Studio është një IDE[1] program i pasur me karakteristika që mund të përdoret për shumë aspekte të zhvillimit të softuerit. Sipër dhe poshtë redaktuesin dhe korrigjuesin standard që sigurojnë shumica e IDE-ve. Visual Studio përfshin përpiluesit, mjetet e kompletimit të kodit, krijuesit grafikë dhe shumë veçori të tjera për të lehtësuar procesin e zhvillimit të softuerit [8].



Figura 2 Visual Studio 2019

[1] integrated development environment (IDE), u mundëson programuesve të konsolidojnë aspektet e ndryshme të shkrimit të një programi kompjuterik:
https://www.codecademy.com/articles/what-is-an-ide

Figura 2 tregon pamjen e Visual Sudio 2019 në një projekt të hapur me disa mjete kyçe të cilat do të përdoren [8]:

- Solution Explorer (lart djathtas) ju lejon të shikoni, të lundroni dhe të menaxhoni file tuaj të kodit. Solution Explorer mund të ndihmojë në organizimin e kodit tuaj duke grupuar file dhe projekte.
- Dritarja Edit Window (në qendër), ku do ta kaloni shumicën e kohës, shfaq përmbajtjen e skedarit (file). Kjo është ajo ku ju mund të modifikoni kodin ose të krijoni një interface përdoruesi (UI) siç është një dritare me butona dhe kuti teksti.
- Team Explorer (poshtë djathtas) ju lejon të gjurmoni artikujt e punës dhe të ndani kodin me të tjerët duke përdorur teknologjitë e kontrollit të versionit siç janë Git i cili gjurmon ndryshimet që bën në fajëll, kështu që të kesh një regjistër të asaj që është bërë dhe mund të kthehesh në versione specifike nëse do të të duhej ndonjëherë dhe Team Foundation Version Control (TFVC) i cili ju ndihmon të gjurmoni ndryshimet që bëni në kodin tuaj me kalimin e kohës.

2.4 SQL Server Management Studio (SSMS)

SQL Server Management Studio (SSMS) është një mjedis i integruar për menaxhimin e çdo infrastrukture SQL, nga SQL Server te Azure SQL Database [9] i cili është një shërbim i plotë i të dhënave, që do të thotë që Microsoft operon SQL Server për ju dhe siguron disponueshmërinë dhe performancën e tij [10]. SSMS ofron mjete për konfigurimin, monitorimin dhe administrimin e instancave të SQL Server dhe bazave të të dhënave.
SSMS përdorët për të kërkuar, dizajnuar dhe menaxhuar bazat e të dhënave tuaja dhe depot e të dhënave, kudo që ndodhen - në kompjuterin tuaj lokal ose në Cloud [9] interneti më konkretisht, janë të gjitha gjërat në të cilat mund të qasemi në distancë përmes internetit. Kur diçka është në Cloud, kjo do të thotë se është ruajtur në serverat e Internetit në vend të diskut të kompjuterit tuaj. Një karakteristikë e veçantë e SSMS është edhe **Object Explorer** [11].



Figura 3 SQL Server Management Studio

2.4.1 Object Explorer

Object Explorer (figura 3 tabela majtas) siguron një interface hierarkike të përdoruesit (UI) për të parë dhe menaxhuar objektet në secilën shembull të SQL Server. Paneli Detajet e Eksploruesit të Objekteve paraqet një pamje tabelare të objekteve të shkallës, dhe aftësinë për të kërkuar objekte specifike. Aftësitë e Object Explorer ndryshojnë pak në varësi të llojit të serverit, por zakonisht përfshijnë tiparet e zhvillimit për bazat e të dhënave dhe tiparet e menaxhimit për të gjitha llojet e serverit [12].

3. MODELET E ZHVILLIMIT NË GJUHËN PROGRAMUESE C#

Modelet e zhvillimit janë zgjidhje tipike për problemet e zakonta gjatë hartimit të një softueri. Ato janë si projeksione të bëra paraprakisht që mund të përshtaten për të zgjidhur një problem të përsëritur të dizajnit në kodin tuaj. Ju nuk mund të gjeni thjesht një model dhe ta kopjoni atë në programin tuaj, mënyrën se si mundeni me funksionet ose libraritë. Modeli nuk është një pjesë specifike e kodit, por një koncept i përgjithshëm për zgjidhjen e një problemi të veçantë. Ju mund të ndiqni detajet e modelit dhe të zbatoni një zgjidhje që i përshtatet programit tuaj. Modelet shpesh ngatërrohen me algoritmet, sepse të dy konceptet përshkruajnë zgjidhje tipike për disa probleme të njohura. Ndërsa një algoritëm gjithmonë përcakton një grup të qartë veprimesh që mund të arrijë një qëllim, një model është një përshkrim më i nivelit të lartë të një zgjidhjeje. Kodi i të njëjtit model që aplikohet në dy programe të ndryshme mund të jetë i ndryshëm. Një analogji me një algoritëm është një recetë gatimi: të dyja kanë të qarta hapat për të arritur një qëllim. Nga ana tjetër, një model është më shumë si një plan: mund të shihet se cili është rezultati dhe tiparet e tij, por rendi i saktë i zbatimit varet nga personi që përdor modelin [2].

3.1. Klasifikimi i modeleve

Modelet e dizajnit ndryshojnë nga kompleksiteti i tyre, niveli i detajeve dhe shkalla e zbatueshmërisë për të gjithë sistemin që po projektohet. Modelet më themelore dhe të nivelit të ulët shpesh quhen **idioma**. Zakonisht ato aplikohen vetëm në një gjuhë të vetme programimi. Modelet më universale dhe të nivelit të lartë janë modelet **arkitektonike**. Zhvilluesit mund t'i zbatojnë këto modele praktikisht në çdo gjuhë. Ndryshe nga modelet e tjera, ato mund të përdorën që të hartoni arkitekturën e një aplikacioni të tërë.

Përveç kësaj, të gjitha modelet mund të kategorizohen nga qëllimi i tyre. Modelet e zhvillimit ndahen në tri grupe [2]:

- **Modelet krijuese (Creational patterns)** sigurojnë mekanizma të krijimit të objekteve që rrisin fleksibilitetin dhe ripërdorimin e kodit ekzistues.
- **Modelet strukturore (Structural patterns)** shpjegojnë grumbullimin e objekteve dhe klasave në struktura më të mëdha, duke i mbajtur strukturat fleksibile dhe efikase.

- **Modelet e sjelljes (Behavioral patterns)** kujdesen për komunikimin efektiv dhe caktimin e përgjegjësive ndërmjet objekteve.

3.2. Historiku i modeleve të zhvillimit

Koncepti i modeleve u përshkrua për herë të parë nga Christopher Aleksandri në *A Pattern Language: Towns, Buildings, Construction* [13]. Libri përshkruan një "gjuhë" për hartimin e mjedisit urban. Njësitë e kësaj gjuhe janë modelet. Ato mund të përshkruajnë sa duhet të jenë dritaret e larta, sa nivele një ndërtesë duhet të ketë, sa hapësira të gjelbërta në një lagje supozohet të jenë, e kështu me radhë. Ideja u mor nga katër autorë: Erich Gamma, John Vlissides, Ralph Johnson dhe Richard Helm. Në 1995, ata botuan *Design Patterns: Elements of Reusable Object-Oriented Software* [1], në të cilin ata aplikuan konceptin e modeleve të dizajnit te programimit. Libri përmbante 23 modele që zgjidhnin probleme të ndryshme të dizajnit të orientuar në objekte dhe u bë njëri ndër librat më të shitura shumë shpejt. Për shkak të emrit të saj të gjatë, njerëzit filluan të e quajti atë "the book by the gang of four" i cili shpejt u shkurtua thjesht "the GOF book". Që atëherë, dhjetëra modele të tjera të orientuara në objekte janë Zbuluar. Pattern approach u bë shumë e popullarizuar në fusha të tjera programimi, kështu që shumë modele të tjera tani ekzistojnë edhe jashtë modelit të orientuar në objekte [2].

3.3 SOLID Parimet

Parimet SOLID janë parimet e zhvillimit që na mundësojnë të menaxhojmë shumicën e problemeve të zhvillimit të softuerit. Robert C. Martin i përpiloi këto parime në vitet 1990. Këto parime ofrojnë mënyra për të kaluar nga kodi i bashkuar ngushtë dhe pak kapsulimi në rezultatet e dëshiruara të nevojave reale të shoqëruara lirshëm dhe të kapsuluara siç duhet. SOLID është shkurtesa e mëposhtme [14]:

- S: Single Responsibility Principle (SRP) - "Çdo modul programi duhet të ketë vetëm një arsye për të ndryshuar"
- O: Open closed Principle (OSP) - "Një modul / klasë softuer është i hapur për zgjerim dhe i mbyllur për modifikim"

- L: Liskov substitution Principle (LSP) - "duhet të jesh në gjendje të përdorësh çdo klasë të prejardhur në vend të një klase prind dhe ta kesh atë të sillet në të njëjtën mënyrë pa modifikuar"
- I: Interface Segregation Principle (ISP) - "që klientët të mos detyrohen të zbatojnë interface që nuk përdorin. Në vend të një interface dhjamore, shumë interface të vogla preferohen bazuar në grupe metodash, secila që shërben nga një nën modul."
- D: Dependency Inversion Principle (DIP) - "modulet / klasat e nivelit të lartë nuk duhet të varen nga modulet / klasat e nivelit të ulët. Të dy duhet të varen nga abstraksionet"

3.4 UML

Për të i kuptuar më mirë shembujt në vazhdim duhet të flasim edhe për UML diagramet, UML shkurt për Unified Modeling Language, është një gjuhë e standardizuar modelimi e përbërë nga një grup i integruar diagramesh, i zhvilluar për të ndihmuar zhvilluesit e sistemit dhe softuerit për specifikimin, vizualizimin, ndërtimin dhe dokumentimin e objekteve të sistemeve softuerike.

UML përfaqëson një koleksion të praktikave më të mira inxhinierike që kanë rezultuar të suksesshme në modelimin e sistemeve të mëdha dhe komplekse. UML është një pjesë shumë e rëndësishme e zhvillimit të softuerit të orientuar në objekte dhe procesit të zhvillimit të softuerit. UML përdor kryesisht shënime grafike për të shprehur hartimin e projekteve softuerike. UML kanë struktura të ndryshme por në këtë punim është përdorur diagrami i klasës figura 4. Diagrami i klasës është një teknikë qendrore e modelimit që përshkon pothuajse të gjitha metodat e orientuara në objekte [15].

Klasat janë një përshkrim i një grupi objektesh të gjithë me role të ngjashme në sistem, i cili përbëhet nga *Atributet* përcaktojnë se çfarë "njohin" objektet e klasës dhe *Operatorët* përcaktojë se çfarë "mund të bëjnë" objektet e klasës. Një shënim i klasës përbëhet nga tre pjesë *Emri i klasës* i cili duket në pjesën e parë, *Atributi i klasës* i cili duket në pjesën e dytë zakonisht lloji i atributit tregohet pas dy pikave dhe Operatorët e klasës (Metodat) tregohen në pjesën e tretë ato janë shërbime që ofron klasa, tipi që kthen metoda zakonisht tregohet

pas dy pikave [16], shenja (+) do të thotë që atributi apo metoda është publike kurse shenja (–) nëse janë private, Figura 4.



Figura 4 Shënimi i klasës

Ekzistojnë pesë lloje kryesore të marrëdhënieve të klasave (Figura 5) [16]:

1. Simple Association - Një lidhje strukturore midis dy klasave, Një vijë solide që lidh dy klasa.
2. Inheritance or Generalization (Trashegimia) - Përfaqëson një marrëdhënie "është-një", Një klasë abstrakte tregohet me shkronja të pjerrëta. Një vijë e fortë me një shigjetë të zbrazët që drejtohet nga fëmija te klasa prindërore.
3. Aggregation - Një lloj i veçantë i Associacionit. Ajo përfaqëson një marrëdhënie "pjesë e", Një linjë e fortë me një diamant të paplotësuar në fund të associacionit, e lidhur me klasën e përbërësit.
4. Composition (Përbërja) - Një lloj i veçantë i Aggregation ku pjesët shkatërrohen kur e tëra shkatërrohet, Një linjë e fortë me një diamant të mbushur në asociacionin e lidhur me klasën e përbërësit.
5. Dependency (Varësia) - Ekziston midis dy klasave nëse ndryshimet në përkufizimin e njërës mund të shkaktojnë ndryshime në tjetrën (por jo anasjelltas), Një vijë e ndërprerë me një shigjetë të hapur.



Figura 5 Marrëdhënia e klasave [16]

3.5 Creational Patterns

Creational patterns ose në shqip Modelet krijuese ofrojnë mekanizma të ndryshëm të krijimit të objekteve, të cilat rrisin fleksibilitetin dhe ripërdorimin e kodit ekzistues, ato ndahen në [2]:

- Factory Method
- Abstract Factory
- Builder
- Prototype
- Singleton

3.5.1 Factory Method

Factory Method është një mënyrë e krijimit të objekteve, por lejimi i nënklasave të vendosin saktësisht se cilën klasë do të instancojnë. Nënklasa të ndryshme mund të implementojnë interface.
Factory Method instancon nënklasën e duhur bazuar në informacionin e furnizuar nga klienti ose të nxjerrë nga gjendja aktuale [17].

Për ta kuptuar më mirë Factory Method është përdorur një shembull i botës reale dhe pastaj është treguar edhe në formë të një programi të shkruar në C#. Konsideroni një dyqan ushqimesh të klasit të lartë në Londër që rezervon avokado gjatë gjithë vitit. Ai mbështetet tek një blerës për të siguruar që avokadot të vijnë rregullisht, pavarësisht nga koha e vitit. Blerësi zgjidhë burimin e avokadove më të mira dhe i furnizon ato në dyqan. Blerësi po operon si një Factory Method, duke kthyer avokadot Keniane, Afrikën e Jugut ose Spanjolle në varësi të periudhës së vitit. Megjithëse prodhimi është i etiketuar, magazinieri nuk është veçanërisht i interesuar për burimin e produkteve [17]. Figura 6 tregon se çfarë mund të ndodhë në periudha të ndryshme të vitit.



Figura 6 Ilustrimi i Factory Method - Avocado sourcing [17]

Shembulli i cili është përdorur mund të tregohet edhe me anë të një UML diagrami. Klienti deklaron një ndryshore të Produktit por thërret një Factory Method për ta instancuar atë. Kjo shtyn vendimin për atë produkt të veçantë për tu krijuar. Në diagramin UML në Figurën 7, ekzistojnë dy zgjedhje: ProductA dhe ProductB [17].



Figura 7 Factory Method UML diagram [17]

Përbërësit e diagramit UML që tregohet në figurën 7 janë:

- IProduct : Interface për produktet
- Product A dhe Product B : Klasat që implementojnë Produktin
- Creator: Siguron Metodën e Fabrikës
- Factory Method: Vendos se cilën klasë do ta instancoj

Dizajni i këtij modeli mundëson që vendimmarrja se cili produkt të instancohet të trajtohet në një vend. Nëse klienti do të dinte për të gjitha opsionet, vendimet do të shpërndaheshin në kodin e tij. Siç është, klienti duhet të merret vetëm me marrjen e produkteve, madje nuk duhet të lidhet në të gjitha nënklasat e ndryshme të produkteve. Sigurisht, klienti mund të ketë më shumë se një krijues, për lloje të ndryshme të produkteve [17].

Një program i thjeshtë që zbaton shembullin e furnizuesit të avokados është treguar në Figurën 6. Secili prej vendeve prodhuese të avokados ka një klasë, dhe të gjithë ata zbatojnë IProduct në mënyrë që të mund të transportojnë avokado te blerësi. Në varësi të muajit, Factory Metoda (linjat 37 – 48) do të zgjedhë të furnizojë ose ProductA (avokado nga Afrika

e Jugut) ose ProductB (avokado nga Spanja). Ekziston edhe një opsion i tretë, një DefaultProduct, i cili zgjidhet kur avokadot nuk janë të disponueshme (në këtë rast, në muajin 3). Linja e rëndësishme është linja 53, e cila tregon që një produkt krijohet nga një fabrikë (blerësi) pa e ditur klienti klasën e produktit, në figurën 18 është treguar kodi i Factory Method [17].

```
1  using System;
2  using System.Collections;
3
   0 references
4  internal class FactoryPattern
5  {
6      // Factory Method Pattern Judith Bishop 2006
7
       5 references
8      internal interface IProduct
9      {
           4 references
10         string ShipFrom();
11     }
12
       0 references
13     internal class ProductA : IProduct
14     {
           4 references
15         public String ShipFrom()
16         {
17             return " from South Africa";
18         }
19     }
20
       0 references
21     internal class ProductB : IProduct
22     {
           4 references
23         public String ShipFrom()
24         {
25             return "from Spain";
26         }
27     }
28
       0 references
29     internal class DefaultProduct : IProduct
30     {
           4 references
31         public String ShipFrom()
32         {
33             return "not available";
34         }
35     }
36
       1 reference
37     internal class Creator
38     {
           1 reference
39         public IProduct FactoryMethod(int month)
40         {
41             if (month >= 4 && month <= 11)
42                 return new ProductA();
43             else
44               if (month == 1 || month == 2 || month == 12)
45                 return new ProductB();
46             else return new DefaultProduct();
47         }
48     }
49
       0 references
50     private static void Main()
51     {
52         Creator c = new Creator();
53         IProduct product;
54
55         for (int i = 1; i <= 12; i++)
56         {
57             product = c.FactoryMethod(i);
58             Console.WriteLine("Avocados " + product.ShipFrom());
59         }
60         Console.ReadKey();
61     }
62 }
```

Figura 8 Factory Method kodi shembull [17]

Figura 9 tregonë daljen pasi është ekzekutuar shembulli i Factory Method.

```
Avocados from Spain
Avocados from Spain
Avocados not available
Avocados  from South Africa
Avocados  from South Africa
Avocados  from South Africa
Avocados  from South Africa
Avocados  from South Africa
Avocados  from South Africa
Avocados  from South Africa
Avocados  from South Africa
Avocados from Spain
```

Figura 9 Dalja e kodit të Factory Method [17]

Factory Method është një model i lehtë që arrin pavarësinë nga klasat specifike të aplikimit. Klienti programon në Interface (në këtë rast, IProduct) dhe lejon që modeli të zgjidhë pjesën tjetër. Një avantazh i veçantë i Factory Method është se ai mund të lidhë hierarkitë e klasave paralele. Nëse secila hierarki përmban një Factory Method, ajo mund të përdoret për të krijuar shembuj të nënklasave në një mënyrë të ndjeshme [17].

3.6 Structural Patterns

Structural Patterns në shqip Modelet Strukturore shpjegojnë sesi të grumbullohen objektet dhe klasat në struktura më të mëdha, duke e mbajtur kështu strukturën më fleksibile dhe efikase. Modelet Strukturore në C# janë [2]:

- Adapter
- Bridge
- Composite
- Decorator
- Facade
- Flyweight
- Proxy

3.6.1 Adapter Pattern

Adapter Pattern shndërron një interface klase në një interface tjetër që klientët presin. Adapter Pattern lejon që klasat të punojnë së bashku edhe pse ato kanë interface të pa pajtueshëm [18].

Supozoni se keni një aplikacion që mund të klasifikohet gjerësisht në dy pjesë: Interface i përdoruesit (UI ose Front-End) dhe baza e të dhënave (Back-End). Përmes interface-it të përdoruesit, klientët mund të kalojnë disa lloje specifike të të dhënave ose objekteve. Baza e të dhënave tuaja është në përputhje me ato objekte dhe mund t'i ruajë ato pa probleme. Gjatë një periudhe kohore, mund të mendoni se keni nevojë të përditësoni softuerin tuaj për të bërë të lumtur klientët tuaj. Kështu që, mund të dëshironi të lejoni që një lloj tjetër objekti gjithashtu të kalojë përmes interfacit të përdoruesit. Por në këtë rast, problemi i parë do të vijë nga baza e juaj e të dhënave sepse nuk mund të ruajë këto lloje të reja të objekteve. Në situatë të tilla, mund të përdorni një përshtatës (adapter) që do të kujdeset për përshtatshmërinë e këtyre objekteve të reja në një formë të pajtueshme që baza juaj e të dhënave të vjetra mund të pranojë [18].

Në një shembull tjetër, mund të llogaritni sipërfaqen e një drejtkëndëshi lehtë. Në klasën Calculator (Llogaritësi), duhet të siguroni një drejtkëndësh në metodën GetArea() për të marrë sipërfaqen e drejtkëndëshit.
Tani është supozuar se doni të llogarisni sipërfaqen e një trekëndëshi. Por kufizimi juaj është që ju doni të merrni zonën e saj përmes metodës GetArea() të klasës Calculator (Llogaritësi). Si mund ta arrini atë? Për t'u marrë me këtë problem, ju bëni një CalculatorAdapter për një trekëndësh dhe kaloni një trekëndësh në metodën e tij GetArea(). Nga ana tjetër, metoda do t'i trajtojë këto trekëndësha si drejtkëndësha për të marrë zonat e tyre nga metoda GetArea () e klasës Calculator (Llogaritësi). Figura 10 tregon diagramin e klasës [18].



Figura 10 Diagrami i klasës te Adapter pattern [18]

Figurat 11 dhe Figura 12 tregojnë implementimin e Adapter Pattern në një program. Interface RectInterface ka një metodë dhe një funksion (linja 5 – 10), klasa Rect trashëgon interface RectInterface dhe është e obliguar të implementojë metodën dhe funksionin e sajë, gjithashtu në klasën Rect janë deklaruar dy variabla double që nevojiten për të llogaritur sipërfaqen e drejtkëndëshit (linja 12 – 32).

Interface tjetër i quajtur TriInterface ka një metodë dhe një funksion i cili përdorët për ta llogaritur sipërfaqen e trekëndëshit (linja 34 – 40), klasa Triangle trashëgon TriInterface dhe është e obliguar që ta implementoj metodën dhe funksionin e sajë, gjithashtu edhe në klasën Triangle janë deklaruar dy variabla double që do të përdorën për ta llogaritur sipërfaqen e trekëndëshit (linja 41 – 61).

Klasa TriangleAdapter trashëgon interface RectInterface dhe është e obliguar të implemetojë metodën dhe funksionin e sajë, në atë klasë është krijuar një objekt i klasës Triangle me anë të cilës do të mundë të qasen përbërësit e klasës Triangle (linja 67 – 85) dhe në fund në main është krijuar një objekt i një Rect dhe është mbushur me vlera, pastaj është thirrur funksioni i cili bënë llogaritjen e sipërfaqes dhe që shfaqë në ekran vlerën e llogaritur, e njëjta mënyrë shkon edhe për klasën Triangle por ne linjën 99 shihet që kalon nga objekti i tipit Rect në tipin Triangle (linja 87–114).

```
using System;

namespace AdapterPattern_Modified
{
    4 references
    internal interface RectInterface
    {
        3 references
        void AboutRectangle();

        4 references
        double CalculateAreaOfRectangle();
    }

    2 references
    internal class Rect : RectInterface
    {
        public double Length;
        public double Width;

        1 reference
        public Rect(double l, double w)
        {
            this.Length = l;
            this.Width = w;
        }

        4 references
        public double CalculateAreaOfRectangle()
        {
            return Length * Width;
        }

        3 references
        public void AboutRectangle()
        {
            Console.WriteLine("Actually, I am a Rectangle");
        }
    }

    1 reference
    internal interface TriInterface
    {
        2 references
        void AboutTriangle();

        3 references
        double CalculateAreaOfTriangle();
    }

    4 references
    internal class Triangle : TriInterface
    {
        public double BaseLength;//base
        public double Height;//height

        1 reference
        public Triangle(double b, double h)
        {
            this.BaseLength = b;
            this.Height = h;
        }

        3 references
        public double CalculateAreaOfTriangle()
        {
            return 0.5 * BaseLength * Height;
        }

        2 references
        public void AboutTriangle()
        {
            Console.WriteLine("Actually, I am a Triangle");
        }
    }
```

Figura 11 Zbatimi i Adapter Pattern [18]

```
62
63      /*TriangleAdapter is implementing RectInterface.
64      So, it needs to implement all the methods defined
65      in the target interface.*/
66
        1 reference
67      internal class TriangleAdapter : RectInterface
68      {
69          private Triangle triangle;
70
            1 reference
71          public TriangleAdapter(Triangle t)
72          {
73              this.triangle = t;
74          }
75
            3 references
76          public void AboutRectangle()
77          {
78              triangle.AboutTriangle();
79          }
80
            4 references
81          public double CalculateAreaOfRectangle()
82          {
83              return triangle.CalculateAreaOfTriangle();
84          }
85      }
86
        0 references
87      internal class Program
88      {
            0 references
89          private static void Main(string[] args)
90          {
91              Console.WriteLine("***Adapter Pattern Modified Demo***\n");
92              //CalculatorAdapter cal = new CalculatorAdapter();
93              Rect r = new Rect(20, 10);
94              Console.WriteLine("Area of Rectangle is :{0} Square unit",
95              r.CalculateAreaOfRectangle());
96              Triangle t = new Triangle(20, 10);
97              Console.WriteLine("Area of Triangle is :{0} Square unit",
98              t.CalculateAreaOfTriangle());
99              RectInterface adapter = new TriangleAdapter(t);
100             //Passing a Triangle instead of a Rectangle
101             Console.WriteLine("Area of Triangle using the triangle adapter is :{ 0} Square unit", GetArea(adapter));
102             Console.ReadKey();
103         }
104
105         /*GetArea(RectInterface r) method does not know that through
106         TriangleAdapter, it is getting a Triangle instead of a Rectangle*/
107
            1 reference
108         private static double GetArea(RectInterface r)
109         {
110             r.AboutRectangle();
111             return r.CalculateAreaOfRectangle();
112         }
113     }
114 }
```

Figura 12 Zbatimi i Adapter Pattern [18]

Figura 13 tregon daljen pasi është ekzekutuar kodin i shembullit të Adapter Pattern.

```
***Adapter Pattern Modified Demo***

Area of Rectangle is :200 Square unit
Area of Triangle is :100 Square unit
Actually, I am a Triangle
```

Figura 13 Të dhënat dalëse të Adapter Pattern [18]

3.7 Behavioral Patterns

Behavioral Patterns në shqip Modelet e Sjelljes kanë të bëjnë me algoritmet dhe caktimin e përgjegjësive ndërmjet objekteve. Modelet e sjelljes në C# janë [2]:

- Chain of Responsibility
- Command
- Iterator
- Mediator
- Memento
- Observer
- State
- Strategy
- Template Method
- Visitor

3.7.1 Observer Pattern

Observer Pattern përcakton një varësi një në shumë midis objekteve në mënyrë që kur një objekt të ndryshojë gjendjen, të gjithë bartësit e saj njoftohen dhe përditësohen automatikisht [1].

Shumë vegla grafike të ndërfaqes së përdoruesit (UI) ndajnë aspektet prezantuese të ndërfaqes së përdoruesit nga të dhënat themelore të aplikacionit. Klasat që përcaktojnë të dhënat e aplikacioneve dhe prezantimet mund të ripërdoren në mënyrë të pavarur. Ata gjithashtu mund të punojnë së bashku. Si një objekt spreadsheet ashtu edhe një objekt bar chart mund të përshkruajnë informacionin në të njëjtin objekt të të dhënave të aplikacionit duke përdorur prezantime të ndryshme. Tabela dhe grafiku i shtyllave nuk dinë për njëri-tjetrin, duke lejuar kështu të ripërdoren vetëm ato që nevojiten. Por ata sillen sikur dinë. Kur përdoruesi ndryshon informacionin në spreadsheet, diagrami me shirita pasqyron menjëherë ndryshimet dhe anasjelltas [1].



Figura 14 Shembulli Observer [1]

Kjo sjellje nënkupton që spreadsheet dhe diagrami i shiritave janë të varur nga objekti i të dhënave dhe për këtë arsye duhet të njoftohen për çdo ndryshim në gjendjen e tij. Dhe nuk ka asnjë arsye për të kufizuar numrin e objekteve të varura në dy, mund të ketë ndonjë numër të ndërfaqeve të ndryshme të përdoruesit për të njëjtat të dhëna [1].

Observer Pattern përshkruan se si të vendosen këto marrëdhënie. Objektet kryesore në këtë model janë **subject** dhe **observers** (vëzhgues). Një subjekt mund të ketë ndonjë numër të vëzhguesve të varur. Të gjithë vëzhguesit njoftohen sa herë që subjekti pëson një ndryshim në gjendje. Si përgjigje, secili vëzhgues do të pyesë subjektin për të sinkronizuar gjendjen e tij me gjendjen e subjektit [1].

